



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:139541

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05557093

**P.nr.83/24**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale ndaj të akuzuarit N. B. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1të Kodit të Përkoshëm Penal të Kosovës (tutje: KPPK), sipas Aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, PP.nr.197/2004 e datës 03.03.2005, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 28.03.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, të akuzuarit N. B. dhe mbrojtëses së tij sipas autorizimit av. Hidajete Mazhiqi, me datë 28.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.04.2024, përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

N. B., nga i ati A., e ëma F., e gjinisë I., i lindur me datë ... në fshatin V. i E. komuna Mitrovicë, ku edhe jeton, me numër personal të identifikimit ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion mekanik, i gjendjes së mesme ekonomike shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

### **Sepse:**

Me datën 04.07.2004, rreth orës 22:30 minuta, në vendin e quajtur “...” në fshatin M., Komuna e Mitrovicës, ka mbajtur dhe përdorur pa autorizim Puushkën M-48 Italiane, me numër serik Q-60. Në atë mënyrë që ka shkaktuar shqetësim dhe frikë tek banorët e atij fshati, ashtu që N. B. së bashku me J. Z. dhe F. Z., ka shkuar në vendin si më lartë, dhe me pushkën e J. ka shtënë tri deri në katër here.

Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 3, 6, 34, 35, 39, 64 lidhur me nenin 327 par.1 e lidhur me të KPPK-së, dhe neneve: 364, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

## **S H Q I P T O N**

- I. Dënim me gjobë në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 39 par.4 të KPPK-së, ashtu që të njëjtit dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 15 € (euro) gjobë me një (1) ditë burgim.
- II. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (20) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

## **A r s y e t i m i**

Ish-Prokuroria Publike e Qarkut, ka ngritur aktakuzën PP.nr.197/2004 të datës 03.03.2005, kundër të pandehurve N. B., J. Z., Z. Z., F. Z. , për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së.

Ish Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me datën 20.06.2005, kishte caktuar dhe mbajtur seancën për konfirmimin e aktakuzës, ndërsa me datën 20.06.2005, kishte marrë Aktvendimin P.nr.128/05, me të cilin kishte konfirmuar Aktakuzën e ish Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë.

Gjykata Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin P.nr.128/05 të datës 01.06.2022, kishte marrë aktvendim me të cilin e kishte hedhur aktakuzën e ish Prokurorisë Publike të Qarkut- tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.197/04 të datës 03.03.2005 dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurve J. Z., Z. Z., F. Z., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, për shkak se kishte arritur parashkrimi relativ në raport me këta të pandehur. Me anë të këtij aktvendimi nga i pandehuri J. Z. është sekuestruar një (1) pushkë e llojit M-48 Italiane, me numër serik Q-60.

Procedura në këtë çështje penale ka vazhduar vetëm sa i përket të akuzurit N. B.

Gjykata Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, me aktpërcjellësin P.nr.128/05 të datës 23.02.2024, në bazë të qëndrimit juridik të Gjykatës Supreme GJ.A.S123/2016 të datës 23.06.2016 është shpallur jo kompetente në aspektin lëndor lidhur me këtë çështje penale ashtu që kjo lëndë është dërguar pranë Departamentit të Përgjithshëm.

Lënda është pranuar në punë me datën 13.03.2024. Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 28.03.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni, i akuzuari N. B. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Hidajete Mazhiqi.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem.

Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se i propozoj gjykatës që t'ia pranoj pranimin e fajësisë të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësja e të akuzuarit sipas autorizimit av. Hidajete Mazhiqi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim dhe sqarimit të natyrës së pranimin të fajësisë, benefitet që i sjell pranimi i fajësisë, i njëjti në baza vullnetare, pa asnjë ndikim, e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës. Pasi që pranimi i fajësisë mbështetet edhe në faktet dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë ndaj të mbrojturit tim.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si Raporti Fillestar i Incidentit 2004-BC-1486 i datës 16.07.2004 Raporti i Oficerit 2004-BC-1486, i datës 16.07.2004, Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin N. B., i datës 21.07.2021, Lista e armëve të sekuestruara nga Shërbimi Policor i Kosovës-Stacioni Policor Mitrovicë Jug, e datës 20.07.2004, fotodokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari N. B. ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë deri në 10.000 euro ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 64 të KPPK-së. Gjykata, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari qysh në seancën për konfirmimin e aktakuzës, faktin se që nga koha e kryerjes së veprës penale

e deri më sot ka kaluar kohë e gjatë, pothuajse 20 vite, si dhe mosha e re të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës, si dhe faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, baba i dy fëmijëve të mitur, keqardhjen e të akuzuarit, premtimin se nuk të përsërisë më vepra të tilla penale. Sipas verifikimit të kësaj gjykate të datës 06.02.2024, i njëjti nuk ka qenë më parë i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm, ndërsa pas kryerjes së kësaj veprë rezulton i dënuar me Aktgjykimin PKR.nr.739/13 i datës 17.11.2014, por ky dënim është i shlyer nga evidenca andaj Gjykata nuk e mori si rrethanë rënduese. Gjithashtu i njëjti rezulton i dënuar me Aktgjykimin P.nr.404/2019 i datës 19.09.2019, mirëpo me qenë se vepra për të cilën është dënuar, është e natyrës tjetër, gjykata nuk e mori si rrethanë rënduese. Rrethana të tjera me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, kjo Gjykatë nuk gjeti.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Poashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 34 të KPPK-së, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij dhe të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprimet e paligjshme në të ardhmen.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par 2 nën par 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, ngase sipas aktakuzës nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Nga arsyet e lartcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal**

**P.nr.83/24, datë 08.04.2024**

Numri i lëndës: 2019:139541  
Datë: 08.04.2024  
Numri i dokumentit: 05557093

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**  
**Marigona LAJQI**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.